



VENDIM

Nr.91 Datë 06.09.2013

PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “SNOW ENERGY” SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2, gërma “a”; 9, dhe nenit 45 pika “4”, dhe 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “ f ”, 5 pika 1 gërma “ f ” dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.09.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SNOW ENERGY” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “SNOW ENERGY” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “SNOW ENERGY” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike, me një afat 5 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari ne Detyre
Shkelqim Bozgo